

|  |                              |
|--|------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO<br>QEVERIA-VLADA-GOVERNMENT  |                              |
| MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE<br>Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine-MINISTRY of Labour and Social Welfare<br>Sektori i Arkivit-Sektor Archive-Archive Sector |                              |
| Shkronja Orig.<br>Original No.   | Nr. Prot:<br>Proj. Prot: 576 |
| g. Himn  | Prot. No:                    |
| Nr. Fletëve<br>Bi. stranic<br>No pages 02  | Data:<br>Datum: 27.12.2019   |
| Prishtinë-Prishtina-Prishtina  |                              |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**  
**Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare**

**Datë: 27/12/2019**

Në mbështetje të nenit 18 të Ligji nr. 06/1 -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarur, të Rregullores 02/2011, për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren Nr. 15/2017, Rregulloren Nr.16/2017, Rregulloren Nr.07/2018, Rregullore Nr. 26/2018, Rregullore Nr 30/2018, Nenin 12 Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale *nxjerr këtë:*

**VENDIM**

**Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve/  
Strehimoreve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale**

**I**

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nga kodet e nënprogrameve buxhetore të MPMS-së 001500 dhe 00600.

**II**

1. Mjetet e përmendura në nenin I. të këtij vendimi do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**III**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës I. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të projektit
2. Forma e buxhetit të projektit
3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklarata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
6. Deklarata për aktivitetet e kontraktorit të përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar projektit

#### IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MPMS-së <http://www.mpms.rks-gov.net>;

#### V

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MPMS do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni Vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

#### VI

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve të OJQ-ve.

2. MPMS do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave dhe do të bëjë transferin e mjeteve financiare tek përfituesit/OJQ-ët.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë departamentet përkatëse që mbulojnë fushat në bazë të thirrjes publike të shpallur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

#### VII

1. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ju dërgohet:

- Ministrit të MPMS-së
- Departamenti Politikave Sociale dhe Familjes
- Divizionit të Buxhetit në MPMS
- Arkivit të MPMS-së

Sekretar i Përgjithshëm i MPMS-së

  
Izedin Bytyqi